



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO  
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS  
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Komuna Vushtrri



## MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM - (MpB)

|  |
|--|
| REPublika e Kosovës - Republika Kosovo |
| KOMUNA E VUSHTRRISË - OPÇTINA VUSHTRRI |
| 02 Nr. / Br. 255/24                    |
| Nr. i fq. / Br. st -04-                |
| Data / Datum 18.03.2024                |
| VUSHTRRI - VUÇITRI                     |

në mes të

Inicijativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me regjistrim Nr: 5200122-6 – përfaqësuar nga z. Zenel Bunjaku, Drejtor, në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”

dhe

Komunës së Vushtrrisë, përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi Kryetar i komunës, në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna e Vushtrrisë”

### I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Vushtrrisë.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-së dhe “Komunës së Vushtrrisë” gjatë vitit 2024, bazuar në zbatimin e projektit “**Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit**” financuar nga FRIEDA dhe zbatuar nga IADK, ndërsa projekti do të ketë shtrirje në Komunën e Vushtrrisë, Lipjanit, Shtimes dhe Mitrovicës.

Palët e lartë cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

### II. Obligimet e IADK-së në zbatimin e projektit

- IADK do të organizojë një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- IADK në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Komuna e Vushtrrisë do të bëjë përzgjedhjen e përfituesëve/pjesëmarrësve të granteve;
- IADK do të furnizojë me të mira të nevojshme përfituesit/pjesëmarrësit e projektit;
- IADK do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetin e “Përfituesve/Pjesëmarrësve”;
- IADK do të organizojë këshilla direkte për përfituesit/pjesëmarrësit e grantit dhe për të përgatitur dhe menaxhuar sa më mirë punët rreth aktiviteteve të tyre bujqësore;
- IADK do të organizojë vizitë 1-ditore në Kosovë, për të gjithë kandidatët që kanë përfituar grante.

Adresa:  
Sfaraçak i Ulët nr.11  
42000 Vushtrri

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!  
Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadc.org](mailto:info@iadc.org)  
Tel: 049777046 & 044777036  
Web: [www.iadc.org](http://www.iadc.org)



- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim të Komunës së Vushtrrisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesve/pjesëmarrësve;
- IADK-ja do të organizojë panairin për prezantimin e produkteve të përfituesve/pjesëmarrësve të projektit, me qëllim të promovimit të aktivitetit të tyre bujqësor;
- Përkrahja e njëmbëdhjetë (11) grave/burrave më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit. Paketa e granteve është e hapur, prandaj gratë/burrat do të aplikojnë me idetë e tyre në vlerë mesatare deri në 2,000 € në të mira (jo në para);
- Përkrahja e njëmbëdhjetë (11) grave/burrave me shërbime këshillimore, trajnime profesionale për përfituesit/pjesëmarrësit e granteve.
- IADK do të organizojë njëzet (20) ditë trajnime në përpunimin e frutave, perimeve, ëmbëlsirave apo produkteve të qumështit për 7 gra të cilat do të përzgjedhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në projekt (të njëjtat do të përcjellin edhe sesione të trajnimeve që do të organizojë IADK përmes projektit FRIEDA);
- Përkrahja e shtatë (7) kandidateve (nga Komuna e Vushtrrisë) që kanë ndjekur trajnimet profesionale do të mbështeten me pajisje të vogla në vlerë 150 €;
- IADK do të ri-mbështetë 10 përfitues/pjesëmarrës të projektit të CFD/FRIEDA-së nga vitet e kaluara në Komunën e Vushtrrisë me një vlerë prej 150€.

### III. Obligimet e “Komunës së Vushtrrisë” në përkrahjen e zbatimit të projektit

- “Komuna e Vushtrrisë” dhe “IADK”-ja pajtohen që të përkrahin njëra-tjetrën në zbatimin e projektit në interes të “Komunës së Vushtrrisë” dhe “IADK”-së të cilat do të zbatohen në “Komunën e Vushtrrisë”;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të përkrahë “IADK”-në në bashkëfinancimin e projektit;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të bashkëfinancojë projektin të përfituesit/pjesëmarrësit e granteve (gratë/burrat, njësin përpunuese, pakot mbështetëse të grave që kanë ndjekur trajnimet profesionale dhe ri-mbështetja e përfituesve/pjesëmarrësve) me 20 % të investimit (shih tabelen 1);
- “Komuna e Vushtrrisë” së bashku me “IADK” do të organizojë sesionet informuese, duke informuar shoqatat, fermerët, gratë dhe burrat të regjistruara në databazën e komunës;
- “Komuna e Vushtrrisë” do t’i ndihmojë “IADK”-së në organizimin e grupeve për trajnimet në sektorin e bujqësisë dhe trajnimeve profesionale;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve/pjesëmarrësve të granteve dhe trajnimeve profesionale;
- “Komuna e Vushtrrisë” mund të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e “Përfituesve/Pjesëmarrësve” edhe pas përfundimit të projektit;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të asistojë IADK-në në organizimin e panairit duke mundësuar lejimin e hapësirës publike, nëse panairi organizohet në Komunën e Vushtrrisë.

- “Komuna e Vushtrrisë” do të përkrahë përfituesit/pjesëmarrësit e projektit në vitet tjera pas përfundimit të projektit me fonde vetenake sa herë që do të ketë mundësi për shkak të gjendjes dhe situatës ekonomike në të cilën gjenden.

| Tab. 1: Kostoja e bashkëfinancimit për grante përkrahëse për përfituesit e Komunës së Vushtrrisë, viti 2024 |  |                       |                    |                       |                  |                                  |                 |                  |
|---|--|-----------------------|--------------------|-----------------------|------------------|----------------------------------|-----------------|------------------|
| Nr.   | Përshkrimi i aktivitetit   | Njësia                | Nr. i përfituesëve | Investimi €/përfitues | Totali €         | Pjesëmarrja e partnerëve         |                 |                  |
|   |  |                       |                    |                       |                  | IADK dhe Donatorët               | Komuna Vushtrri | Përfituesit      |
| 1   | Përkrahje e grave dhe burrave në sektorin e bujqësisë  | Përfitues/pjesëmarrës | 11                 | 2,000.00              | 22,000.00        | 15,400.00                        | 4,400.00        | 2,200.00         |
| 2   | Grante të vogla në sektorin e përpunimit (gratë që ndjekin trajnime profesionale)  | Pjesëmarrëse          | 7                  | 150.00                | 1,050.00         | 840.00                           | 210.00          | -                |
| 3   | Shpenzimet e transportit dhe ushqimit për pjesëmarrësit në trajnime profesionale   | Pjesëmarrëse          | 7                  | 200.00                | 1,400.00         | 1,120.00                         | 280.00          | -                |
| 4   | Shpenzimet e ekspertit për realizimin e trajnimeve profesionale  | Ekspert               | 1                  | 1,035.00              | 1,035.00         | 828.00                           | 207.00          | -                |
| 5   | Ri-mbështetja me grante të vogla për përfituesit/pjesëmarrësit egzistues   | Përfitues/pjesëmarrës | 10                 | 150.00                | 1,500.00         | 1,200.00                         | 300.00          | -                |
| <b>Total direkte</b>  |  |                       |                    |                       | <b>26,985.00</b> | <b>19,388.00</b>                 | <b>5,397.00</b> | <b>2,200.00</b>  |
| 6   | Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte, trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontratës me përfitues |                       |                    |                       | 8,095.50         | 6,476.40                         | 1,619.10        | -                |
| <b>Buxheti total</b>  |  |                       |                    |                       | <b>35,080.50</b> | <b>25,864.40</b>                 | <b>7,016.10</b> | <b>2,200.00</b>  |
|   |  |                       |                    |                       |                  | <b>IADK</b>                      | <b>Komuna</b>   | <b>Fermeri</b>   |
|   |  |                       |                    |                       |                  | <b>74%</b>                       | <b>20%</b>      | <b>6%</b>        |
|   |  |                       |                    |                       |                  | <b>Investimi total në Komunë</b> |                 | <b>35,080.50</b> |

**Shënim:** Në pikën 1 nga tabela e mësipërme, përparësi do t'u jepet grave dhe burrave për përkrahje me grante në sektorin e hortikulturës (pemë, perime), blegtorisë dhe bletarisë.

#### IV. Mënyra e pagesës së bashkëfinancimit nga Komuna e Vushtrrisë

- “Komuna e Vushtrrisë” do t'i bëjë pagesën IADK-së për bashkëfinancim gjatë vitit 2024, pas zbatimit të projekteve dhe dorëzimit të raportit final për mbështetjen e lartë cekur, listën e përfituesve/pjesëmarrësve dhe kërkesës për pagesë, nga ana e IADK-së;
- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në **Nr.xhir:2027-000021-7128-84**, në emër të IADK-së;
- Varësisht nga numri i përfituesve/pjesëmarrësve dhe vlera e investimit në Komunën e Vushtrrisë, do të bëhet edhe bashkëfinancimi (me vlerën 20% nga investimi total nga Komuna e Vushtrrisë). Bashkëfinancimi për rritjen apo zvogëlimin e numrit të përfituesve/pjesëmarrësve do të bëhen në mënyrë proporcionale;
- Përzgjedhja e përfituesve/pjesëmarrësve do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë, poashtu kontratat me përfituesit/pjesëmarrësit



e projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi/pjesëmarrësi);

#### V Përgjegjësi të tjera

- "IADK" do të njoftoj në mënyrë të rregullt dhe do të raportoj në fund të projektit tek "Komuna e Vushtrrisë" për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të MpB;
- "IADK" do të njoftoj me kohë "Komunën e Vushtrrisë" për mundësinë e vazhdimit të MpB pas vitit 2024;

#### VI Personat Kontaktues

"IADK"-ja dhe "Komuna e Vushtrrisë" do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshiheshin drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB. "IADK" do të përfaqësohet nga Znj. Ylberinë Baliu ndërsa "Komuna e Vushtrrisë" do të përfaqësohet nga Rabije Zahiti.

#### VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga 01.03.2024 deri më 31.12.2024, dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.

Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

#### VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Buiqësisë së Kosovës (IADK)



Zenel Bunjaku  
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 18/03 2024

Komuna e Vushtrrisë



Ferit Idrizi  
Kryetari i Komunës

Vushtrri 18.03 2024

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11  
42000 Vushtrri

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!*  
*Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadc.org](mailto:info@iadc.org)

Tel: 049777046 & 044777036

Web: [www.iadc.org](http://www.iadc.org)